

DITARI MUJOR

PRILL 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

VATIKAN, MINISTRJA PIRDENI MERR PJESË NË MESHËN E SHENJTË PËR PAPA FRANÇESKUN

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni ishte pjesë e delegacionit zyrtar nga Shqipëria që mori pjesë në ceremoninë mortore të Papa Françeskut në Vatikan, të kryesuar nga Presidenti i Republikës Z. Bajram Begaj.

Shërbesa e Meshës së Shenjtë u mbajt përpara Bazilikës në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan. Papa Françesku kishte një lidhje të veçantë me Shqipërinë. Në shtator të vitit 2014, ai vizitoi vendin tonë, duke sjellë mesazhe shprese dhe afërsie për popullin shqiptar. Vetëm dy vite më pas, më 4 shtator 2016, Papa Francesku shpalli Shenjtore Nënë Terezën, krenarinë tonë kombëtare.



MINISTRJA PIRDENI NË KONFERENCËN "LEGJISLACIONI SHQIPTAR NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN"

Ministrja Pirdeni mori pjesë në Konferencën Shkencore Kombëtare "Legjislacioni shqiptar në procesin e integrimit evropian. Roli i institucioneve midis sfidave për përafrimin", në Fakultetin e Drejtësisë, UT.

Konferenca mbledhi së bashku akademikë, studiues, përfaqësues të institucioneve publike dhe studentë për të diskutuar mbi sfidat dhe përparësitë e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Gjatë fjalës së saj, ministrja Pirdeni ndau mendime me pedagogë e studentë, për hapat që po ndërmerren vendi për të përshpejtuar reformat e agjendës sonë evropiane.



MAPA DHE MIA, ORGANIZOJNË TAKIM INFORMUES ME STUDENTËT MBI INTEGRIMIN EVROPIAN

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) në bashkëpunim me Agjencinë për Media dhe Informim (MIA), organizuan një takim informues me një grup studentësh degës Shkenca Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale, UT.

Aktiviteti u organizua për të diskutuar nga afër mbi sfidat dhe përparësitë e procesit të integrimit evropian të Shqipërisë.

Diskutimi u fokusua në momentumin e rëndësishëm që Shqipëria ka drejt sfidës historike të aderimit në BE brenda kësaj dekade.

Gjatë fjalës, ministrja Pirdeni, prezantoi agjendën ambicioze të qeverisë shqiptare për mbylljen e negociatave teknike deri në vitin 2027, duke theksuar se procesi i përafrimit me legjislacionin evropian po ecën me ritme të shpejta.

Studentët u përfshinë aktivisht në diskutim, duke ngritur pyetje mbi aderimin e vendit në Bashkimin Evropian.



BARI, PROGRAMI I SHKËMBIMIT TË NËPUNËSVE PUBLIKË TË BALLKANIT PERËNDIMOR DO TRAJNOJNË NËPUNËSIT SHQIPTARË

Në Bari të Italisë, u mbajt edicioni i dytë i Programit për Shkëmbimin dhe Rritjen e Kapaciteteve të Nëpunësve Publikë nga Ballkani Perëndimor.

Delegacioni shqiptar në këtë konferencë përfaqësohej nga Znj. Fotjona Taçe, Shefe e Kabinetit pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Znj. Silvana Rusi, këshilltar pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Në emër të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Taçe përshëndeti konferencën "Drejt një hapësire të përbashkët administrative Evropiane: Lidhja e Ballkanit Perëndimor me Administratën Italiane".

Gjatë fjalës, Znj. Taçe theksoi se programi përfaqëson një hap domethënës në rrugëtimin tonë të përbashkët drejt administratave publike moderne, të bashkuara nga vizioni i përbashkët për standarde dhe vlera evropiane.



DITARI MUJOR

PRILL 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

LUKSEMBURG, SHQIPËRIA HAP GRUP-KAPITULLIN E DYTË TË NEGOCIATAVE “TREGU I BRENDSHËM” ME BASHKIMIN EUROPIAN

Në Luksemburg, Shqipëria ka hapur grup-kapitullin e dytë të negociatave me Bashkimin Europian “Tregu i Brendshëm”, në Konferencën e katërt ndërqeveritare Shqipëri – BE. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni, ishte pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga Kryeministri Edi Rama. Në Bruksel, Kryeministri Edi Rama u prit nga Presidenti i Këshillit Europian Antonio Costa, e më pas delegacioni shqiptar udhëtoi drejt Luksemburgut ku mori pjesë në Konferencën e katërt ndërqeveritare Shqipëri-BE, ku ishte e pranishme Komisionerja e BE-së për Zgjerimin Marta Kos dhe Radosław Sikorski, ministër i Punëve të Jashtme të Polonisë, e cila mban Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian. Gjatë konferencës për shtyp Kryeministri Rama tha se bashkë me BE-në është rënë dakord për një agjendë mjaft ambicioze. Komisionerja e BE për Zgjerimin, Znj. Marta Kos u shpreh se do të jetë avokatja më e mirë e Shqipërisë në Bruksel për Shqipërinë teksa dha një mesazh për qytetarët shqiptarë.



WASHINGTON D.C, MINISTRJA PIRDENI MERR PJESË NË FORUMIN GLOBAL PËR PARTNERITETIN NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT



Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni, mori pjesë në “Forum Global për Partneritetin për Antikorrupsionin”, zhvilluar në Washington D.C., SHBA, i organizuar nga Aleanca Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit e Grupit të Bankës Botërore, në bashkëpunim me Programin Global për Antikorrupsionin, të njohura për kontributin e tyre me ndikim global në fushën e transparencës dhe luftës kundër korrupsionit.

Ministrja Pirdeni ndau përvojën shqiptare si folëse në panelin “Rreziqet e korrupsionit në Prokurimin Publik, një qasje krahasuese ndërkombëtare”, në “Forum Global për Partneritetin për Antikorrupsionin”, ku foli për zhvillimet aktuale në Shqipëri, vend i renditur i pari në rajon nga OECD/SIGMA në menaxhimin e financave publike. Më tej ministrja Pirdeni u theksoi gjatë fjalës në nismën më inovative për modelin e mundësuar nga Inteligjenca Artificiale, që do të nisë vitin e ardhshëm, si dhe forcimin e sistemit të certifikimit të të gjithë zyrtarëve publikë, në funksion të integritetit në shpenzimin e parasë publike.

TAKIMI I DYTË I NIVELIT TË LARTË “SHQIPËRIA 2030 NË BE – RRUGA E REFORMAVE”, PREZANTOHET DRAFTI I PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Kuvendi i Shqipërisë ka organizuar takimin e dytë të nivelit të lartë “Shqipëria 2030 në BE – Rruga e Reformave”. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, e pranishme në panel, vlerësoi punën e bërë nga të gjithë aktorët e përfshirë në hartimin e këtij plani dhe theksoi rëndësinë e qasjes proaktive dhe kontributit real për ndërtimin e një dokumenti që mbështet objektivin e Shqipërisë për integrimin në BE. Ministrja Pirdeni gjithashtu nënvizoi nevojën për një ndërveprim të ngushtë për të siguruar që mekanizmat e mirëqeverisjes dhe lufta kundër korrupsionit të funksionojnë me efikasitet dhe të kontribuojnë realisht në ecurinë e negociatave me BE-në.



Ministër i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni